



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 59 dt. 15.09.2014

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 15.09.2014, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projekteve të Bashkisë Lezhë.
 - *Projekt rikualifikimi i sheshit Gjergj Kastrioti, Lezhë.*
 - *Rikonstruksioni i urës së lumit Drin, në qendër të qytetit të Lezhës.*
 - *Rikualifikim i sheshit të qendrës “Beslidhja”, Lezhë.*
 - *Rikualifikimi i lulishtes para memorialit të Skënderbeut “Rruga e poezisë”, Lezhë.*
 - *Rikualifikim i lulishtes së qendrës, Lezhë.*
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore punimet të mbikqyren nga specialistë të IMK dhe ASHA.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI